



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:023278  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05872308

**K.DH.SH.II.nr.676/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ceren Naklyat Messillik Dis Tickaret Anonim Sirketi, me seli ne Stamboll, te cilin e përfaqëson sipas Autorizimit Arber Rrustaj, avokat nga Prishtina, ndaj debitorit 3E Group SHPK me NUI 811886053 me seli ne Gjilan, magjistrerja M25-3, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.696/23 i dt.17.01.2024, me datën 13.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Ceren Naklyat Messillik Dis Tickaret Anonim Sirketi, me seli ne Stamboll ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.696/23 i dt.17.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për Çështje Ekonomike Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.696/23 i dt.17.01.2024, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor Pnr.nr.162/23 të datës 30.03.2023 i lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, , me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, të merr aktvendim me të cilin aprovet në tërësi ankesa e ushtruar nga

kreditori, si e bazuar, të priset aktvendim i atakuar dhe te mbretet ne fuqi urdhëri përmbarimore ose lënda te kthehet ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave te përshkruara ne propozimin e urdhrin përmbarimor dhe aktvendimin e ankimuar. Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. CER2023000000022, e datës 06.01.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 162/23, të datës 30.03.2023, me të cilin është urdhëruar debitorit që në emër të faturës, menjëherë pas pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 1,200.00, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke filluar nga data e kur kërkesa është bërë e arritshme, data 16.02.2023 e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shumën prej EUR 104.00 në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapsim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, me arsyetim se mos pagesa e faturës mbi të cilën është lejuar urdhri është bërë për faktin se kreditori nuk i është përmbajtur marrëveshjes me debitorit ashtu që ka rënë në vonesë në transportimin e mallrave tek debitorit dhe si rezultat i kësaj është dëmtuar debitori. Ndërsa, ka shtuar se nga shuma e kërkuar për përmbushje debitori ka paguar vlerën prej EUR 750.00 çka dëshmohet nga dëftesa mbi pranimin e pagesës, ndërsa për pjesën tjetër të detyrimit ka paraqitur vërejtje për shkak të vonesës në lifterim të mallrave. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se nga prapësimi i debitorit nuk është kontestuar që nuk është bërë pagesa e plotë e faturës në shumën e kërkuar si në propozim, mirëpo që janë paraqitur kundërshtime në raport me respektimin e marrëveshjes për transportin e mallrave me pretendimet qe debitorit i është shkaktuar dëm. Ndërsa, kreditori ka bërë precizimin e shumës nga shuma EUR 1,200.00, në EUR 450.00, duke i propozuar gjykatës që urdhrin përmbarimor ta lej në fuqi për lartësinë e detyrimit prej EUR 450.00.

Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkalles se pare, Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimine ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se ne shkresat e lendes Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshmë:

“LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkak që si në vijim: Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”. Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, përkatësisht Fatura nr. CER2023000000022, e datës 06.01.2023, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e njëjta është pranuar nga debitori, për arsye se faturës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Gjykata, gjatë vendosjes në këtë çështje përmbartimorë mori parasysh fletëkthesën për dorëzim personal të bashkëngjitur në shkresë të lëndës, përmes së cilës është pretenduar se fatura i është dorëzuar debitorit, mirëpo një dorëzim të tillë gjykata nuk mund ta konsideroj si dorëzim të rregullt dhe pranimit të faturës nga ana e debitorit, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se fatura debitorit i është dorëzuar në postë nga ana e avokatit, ndërsa dorëzimi i faturës nuk është kryer nga ana e kreditorit. Për më tepër, nga dëftesa nr. 0001914, e datës 11.01.2023, të dorëzuar nga debitori në prapësim, rezulton se debitori ka kryer pagesë në emër të faturës në lartësinë prej EUR 750.00, ndërsa për detyrimin në vlerë të mbetur prej EUR 450.00 në të njëjtën dëftesë ka paraqitur vërejtje në raport me pjesën tjetër të detyrimit në faturë, dhe rrjedhimisht tentimi që e njëjta faturë e kundërshtuar më parë t’i dorëzohet debitori përmes postës, rezulton të jetë veprim i ndërmarr nga ana e avokatit vetëm me qëllim të krijimit të kushteve për inicimin e procedurës përmbartimorë. Prandaj, gjykata vlerëson se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor e të cilën e ka kundërshtuar debitori për nga lartësia e detyrimit, përbën dokument të njëanshëm të lëshuar nga kreditori dhe, si e tillë, nuk është e përshtatshme për përmbartim. Përfundimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilës Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimorë kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Në këtë rast e

rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Kolegji i kësaj gjykate pranon në tersi qëndrimin faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë kur ka aprovuar prapësimin dhe shfuqizuar Urdhrin përmbartimor për arsye se, dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, përkatësisht Fatura nr. CER2023000000022, e datës 06.01.2023, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e njëjta është pranuar nga debitori, për arsye se faturës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Gjithashtu kolegji vlerëson se drejta ka vendosur shkalla e parë kur ka konsideruar lidhur me fletëkthesën për dorëzim personal të bashkangjitur në shkresa të lëndës, përmes së cilës është pretenduar se fatura i është dorëzuar debitorit, mirëpo një dorëzim të tillë gjykata nuk mund ta konsideroj si dorëzim të rregullt dhe pranim të faturës nga ana e debitorit, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se fatura debitorit i është dorëzuar në postë nga ana e avokatit, ndërsa dorëzimi i faturës nuk është kryer nga ana e kreditorit. Për më tepër, nga dëftesa nr. 0001914, e datës 11.01.2023, të dorëzuar nga debitori në prapësim, rezulton se debitori ka kryer pagesë në emër të faturës në lartësinë prej EUR 750.00, ndërsa për detyrimin në vlerë të mbetur prej EUR 450.00 në të njëjtën dëftesë ka paraqitur vërejtje në raport me pjesën tjetër të detyrimit në faturë, dhe rrjedhimisht tentimi që e njëjta faturë e kundërshtuar më parë t’i dorëzohet debitori përmes postës, rezulton të jetë veprim i ndërmarr nga ana e avokatit vetëm me qëllim të krijimit të kushteve për iniciimin e procedurës përmbartimore. Prandaj, gjykata vlerëson se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor e të cilën e ka kundërshtuar debitori për nga lartësia e detyrimit, përbën dokument të njëanshëm të lëshuar nga kreditori dhe, si e tillë, nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Gjykata pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjta nuk janë të vullosura e as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të

konsiderohen si dokumente te besueshme, ndërsa vlerëson se me te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij. Përfundimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilës Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.676/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi